



Pranuar / Dorezuar Primiçeno/Prodato Received/Delivory	25-08-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednitsa Org./Unit	Nr Prof Br. Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	4984/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.635/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.635/2022 të datës 20.07.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me banim [redacted]

[redacted] Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 25.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.635/2022 e datës 20.07.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

II. Anulohet Vërejtja me shkrim e shqiptuar përmes e-mailit zyrtar të datës 15.07.2022 e shqiptuar nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] është e punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë sipas Akt emërimit të datës 09.10.2017 në pozitën "Zyrtar ligjor 2", pranë Divizionit për mbikëqyrjen dhe zbatimin e legjislacionit në Departamentin ligjor. Me datën 15.07.2022, Udhëheqësi i drejtpërdrejtë, përmes e-mailit zyrtar i ka shqiptuar ankueses Vërejtjen me shkrim, me arsyetimin se e njëjta nuk ka përmbushur detyrat funksionale ngase ka bërë shkelje të

përsëritur të rregullave të kodit të etikës, kryerjen e përsëritur brenda ose jashtë orarit zyrtar të veprimeve që cenojnë nëpunësit civil si dhe shkeljen e detyrimeve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

Ankuesja e pakënaqur me Vërejtjen e shqiptuar të datës 15.07.2022, e shqiptuar nga ana e Udhëheqësit të saj të drejtpërdrejtë, me datën 20.07.2022, përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesën me Nr.Prot:4209/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit për zyrtarët publikë dhe Rregullores për disiplinën dhe ankesat e zyrtarëve publikë, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit jo të drejtë të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 21.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me datën 29.07.2022 përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 20.07.2022 me Nr.Prot:4209/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen e shqiptuar përmes e-mailit zyrtar të datës 15.07.2022; E-mailat zyrtar të datës 14.07.2022; Vendimin me numër Ref.02/Nr.121 të datës 07.04.2022; Vendimin me numër Ref.02/Nr.61 të datës 02.03.2022; Vendimin me numër Ref.02/Nr.31 të datës 09.02.2022; Vendimin me numër Nr.02 Ref.154 të datës 17.09.2021; Vendimin me numër Ref.02/Nr.95 të datës 04.08.2021; Vendimin me numër Ref.02/Nr.103 të datës 12.08.2021; Vendimin me numër Nr.134/2021 të datës 27.10.2021; Vendimin me numër Ref.02/Nr.178 të datës 17.05.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjiën në ankesë të datës 29.07.2022 nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit e ankueses të datës 09.10.2017 së bashku me përshtkrimin e detyrave të punës të datës 07.03.2017.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka vërtetuar se ankesa e ankueses **është e bazuar, sepse:**

Kolegji lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, ka analizuar Vërejtjen me shkrim të datës 15.07.2022 e shqiptuar përmes e-mailit zyrtar nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses dhe rrjedhimisht ka gjetur se kjo vërejtje bazohet në faktin se ankuesja nuk ka zbatuar hierarkinë institucionale brenda Divizionit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe Departamentit ligjor në Ministrinë e Industrisë dhe Ndërmarrësisë, pasi që gjatë dërgimit të e-mailave paraprak e ka njoftuar në Cc Sekretarin e Pergjithshëm të kësaj ministrie lidhur me angazhimet në punë dhe aktivitetet e saj brenda dhe jashtë ministrisë. Ndërlidhur me situatën juridike të pretenduar, Kolegji ka analizuar edhe faktet dhe provat të cilat i ka dorëzuar ankuesja me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill dhe ka konstatuar se këto fakte dhe prova lidhen direkt me punën e saj që në bazë të vendimeve të Sekretarit të Pergjithshëm, e njëjta është caktuar

si anëtare në grupe punuese dhe anëtare nëpër komisione për çështje të caktuara nga fushëveprimtaria e këtij institucioni dhe për punën në këto grupe, ka pasur obligim të raportojë direkt Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar shkresat e lëndës dhe provat të cilat i ka dorëzuar ankuesja, ka konstatuar se ankuesja me datën 14.07.2022 me rastin e dërgimit të e-mailit për tek Drejtori i departamentit ligjor të kësaj ministrie, ku sqaron se në cilat aktivitete është e angazhuar brenda dhe jashtë ministrisë, përveq Sekretarit të Përgjithshëm të cilin e ka përfshirë në Cc lidhur me njoftimin, në këtë e-mail gjithashtu është i njoftuar (përfshirë) edhe udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë.

Në aspektin e vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ju referua dispozitave të nenit 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *"1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, respektivisht nisur nga ky përcaktim ligjor dhe duke u bazuar në konstatimet si më lartë, Kolegji vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga elementet që do ta bënte përgjegjëse ankuesen lidhur me shkeljet disiplinore për shkeljen e hierarkisë brenda institucionit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të përgjigjes në ankesë nga ana e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhënë për Këshillin me datën 29.07.2022, ku Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë ka deklaruar se, citoj: *"Divizioni i Burimeve Njerëzore, ju njofton se nuk ka pranuar asnjë vërejtje nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i saj dhe nuk posedon vërejtje në dosjen personale të* ka konstatuar se vërejtja e shqiptuar përmes e-mailit zyrtar të datës 15.07.2022 ndaj ankuses nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i saj, pasi që nuk është percjellur për tek zyra e personelit dhe meqë nuk është vendosur në dosjen e ankuses, atëherë mbi bazën e këtij fakti edhe nuk ka prodhuar efekt juridik për ankuesen dhe konsiderohet se nuk është në fuqi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenet 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, dhe në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, të pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.635/2022, datë 25.08.2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet

- ❖ Ankueses
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

